




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 06L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”), nenit 27 paragrafi 6 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës në Rahovec me Nr. Prot. 01 Nr. 275/24, i datës 22.11.2024, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, **SHFUQIZOHET** kontrata me Nr. Prot. 2099, e datës 24.5.2013, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe aneks-kontrata me Nr. Prot. 02/150, e datës 10.2.2023 mbi kontratën bazë me Nr. Prot. 2099, e datës 24.5.2013.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ka marrë rekomandim me nr. prot. 01 Nr. 807, të datës 28.2.2013, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh, respektivisht hotel “Park Plaza” në Rahovec, sipas ofertës me të favorshme ekonomike të Sh.P.K. “Moderne” në Rahovec.

Provë: Rekomandimi i Kuvendit të Komunës me Nr. Prot. 01 Nr. 807, të datës 28.02.2013.

Në pikën 3 të këtij rekomandimi, është autorizuar kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me përfituesin e pronës së paluajtshme të komunës mbi përgjegjësitë dhe detyrat e palëve kontraktuese.

Duke u bazuar në pikën 3 të rekomandimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, ka nënshkruar kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me Nr. Prot. 2099, të datës 24.05.2013, në të cilën janë paraparë detyrimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Rahovecit dhe përfituesit e pronës së paluajtshme të Komunës Sh.P.K. “Moderne” në Rahovec, ku ndër të tjera, në nenin 2, pika 2.4, është paraparë edhe shuma e investimit sipas projektit ideor të

paraqitur nga Sh.P.K. "Moderne" prej 2.628.792,00€ (dy milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy euro).

Provë: Kontrata me Nr. Prot. 2099 të datës 24.05.2013.

Duke u bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr. 06L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, komuna është e detyruar të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Andaj, me propozim të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit, ka caktuar komisionin për vlerësimin e investimeve në hotel "Park Plaza" në Rahovec, me Nr. Prot. 02/1894, të datës 13.4.2022.

Provë: Vendim për caktimin e komisionit me Nr. Prot. 02/1894, të datës 13.4.2022.

Pas daljes në terren, në verifikim të subjekti i lartpërmendur, komisioni ka hartuar raportin me nr. prot. 2774, të datës 3.8.2022, në të cilin është përshkruar gjendja faktike e faturave investive të paraqitura nga përfituesi i pronës së paluajtshme të komunës Sh.P.K. "Moderne" në Rahovec, e që sipas këtij raporti për periudhën prej marrjes në shfrytëzim të pronës 24.5.2013 e deri më datë 3.8.2022 (data e hartimit të raportit, vlera e përgjithshme investive nga Sh.P.K. "Moderne" në Rahovec është 101.175.10€ (njëqind e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e dhjetë cent).

Provë: Raporti i komisionit me nr. prot. 2774, të datës 3.8.2022.

Pas kësaj, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 27, paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në cilësinë e kryetarit të Komunës, e kam njoftuar me shkrim Kuvendin e Komunës për moszbatimin e kontratës dhe projektit ideor të përfituesit të pronës së paluajtshme të komunës Sh.P.K. "Moderne" në Rahovec, me njoftimin me Nr. Prot. 02/5029, i datës 20.11.2024.

Provë: Njoftimi dhe rekomandimi me nr. prot. 02/5029, i datës 20.11.2024.

Kuvendi i Komunës në Rahovec, pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe fakteve, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.11.2024, ka marrë vendim për shfuqizimin e rekomandimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, respektivisht hotel "Park Plaza" në Rahovec.

Po ashtu në pikën 2 të këtij vendimi, është autorizuar kryetari i Komunës që të marrë vendim për shkëputjen e kontratës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me Sh.P.K. "Moderne" në Rahovec, si përfitues i pronës së paluajtshme të komunës.

Provë: Vendimi i Kuvendit të Komunës me Nr. Prot. 01 Nr. 275/24, i datës 22.11.2024.

Andaj, pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe fakteve, si dhe duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 01 Nr. 275/24, i datës 22.11.2024, si dhe duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenin 27, paragrafi 6 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të parashtimit të padisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Padia nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Samir Miftari, përfaqësues i Sh.P.K. "Moderne" në Rahovec,*
- *Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

